



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 22 Prill 2021

Nr: 34

VENDIM I NDËRMJETËM
PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 15, DATË
21.04.2021 DHE NR. 21, DATË 22.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 15, datë 21.04.2021 dhe nr. 21, datë 22.04.2021 të paraqitura në KQZ në datën 22.04.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe neni 65, shkronja “ç” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Bindja Demokratike (BD), ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 15 regj, datë 21.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 225, datë 20.04.2021 të KZAZ nr .30 “Për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor”.

Po ashtu Partia Aleanca Demokracia e Re (ADR) ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 21 regj, datë 22.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 226, datë 21.04.2021 të KZAZ nr. 30, qarku Tiranë “Për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 22.04.2021, me vendimet nr. 26 dhe nr. 31, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat ankimore të paraqitura në KQZ në datën 21.04.2021 dhe 22.04.2021. Relatorët e kërkesave ankimore, përkatësisht z. Ilirjan Rusmali dhe z. Elvin Lako konstatuan se të dy kërkesat ankimore bazohen në nenin 6 të K. Zgjedhor që parashikon ndër të tjera të drejtën e subjekteve zgjedhore për të caktuar vëzhgues. Të dy kërkesat janë iniciuar nga subjekte zgjedhore që ankimojnë vendimmarrje të KZAZ Nr. 30 “Për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor” që lidhen me afatin e parashikuar në pikën 5 të nenit 6 të K.Zgjedhor. Neni 65 shkronja “ç” i K.Pr.Administrative parashikon se *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme: ... ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore”*.

Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 15, datë 21.04.2021 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 21, datë 22.04.2021, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Ilirjan Rusmali.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe neni 65, shkronja “ç” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.



V E N D O S I:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 15, datë 21.04.2021, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike dhe nr. 21, datë 22.04.2021, të paraqitur nga Partia Aleanca Demokracia e Re.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 23.04.2021, ora 11:00, nga relatori z. Ilirjan Rusmali.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Elvin LAKO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

